



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Autoriteti i Konkurrencës hap hetim paraprak në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz

Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur hapjen e procedurës së **hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes SHPRESA – AL SHPK** në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz.

Ky vendim është marrë **pas ankesave të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe shqetësimeve të bëra publike në media**, lidhur me rritjen e çmimeve të biletave dhe aboneve të transportit urban.

Hetimi paraprak ka për objekt **analizimin e kushteve të konkurrencës së lirë dhe efektive** në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz, veçanërisht për linjat:

- **Kamëz – Tiranë – Kamëz**
- **Paskuqan – Babrru – Tiranë**

Referuar dokumentacionit zyrtar të administruar, rezulton se **ndërmarrja SHPRESA – AL SHPK është i vetmi operator i licencuar** për ofrimin e shërbimit të transportit urban në këto linja, duke zotëruar kështu **pozitë dominuese në treg**, në kuptim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Nga vlerësimi paraprak i kryer nga Autoriteti i Konkurrencës, rezulton se **nuk janë administruar analiza të plota ekonomike apo financiare** që të provojnë se rritja e tarifave të biletave dhe aboneve është e mbështetur në rritje reale të kostove, është ekonomikisht e nevojshme dhe e justifikuar mbi baza objektive të tregut.

Hetimi paraprak do të përfshijë **periudhën kohore nga 1 janar 2025 deri më 12 dhjetor 2025**, me qëllim vlerësimin nëse sjellja e ndërmarrjes SHPRESA – AL SHPK mund të përbëjë **kufizim, shtrembërim ose pengim të konkurrencës**, në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003.

Autoriteti i Konkurrencës do të vijojë me trajtimin e çështjes dhe do të informojë publikun për rezultatet e procedurës dhe çdo vendimmarrje të mëtejshme.